# Bilbil i Prillit

# ABETARE

## Për

## Bijat Mbesimtare

Femër, mashkull, vogël, i math, pothuaj sicili shqiptar
Ta mësojë gjuhën shqipe që të rojë mbesimtar
Se me anën e këndimit gjurmon besën e vërtetë
Kush lëçit librat besare trashëgon më të dy jetë.

*Hafëz Abdull-llah Sëmlaku*

Hëna Dhil-Kade 1347. Muaji: Prill

Shtyp. Dhori Koti — Korcë

BKSH

ВКSH

## Shkronjat e shtypit të vogla

a b c ç d dh e ë
f g gj h i j k l ll m
n nj o p q r rr s sh
t th u v x xh y z zh

---

## Shkronjat e shtypit kryesore

A B C Ç D DH E Ë
F G GJ H I J K L
LL M N NJ O P Q
R RR S SH T TH U
V X XH Y Z ZH

Për me e mproit librën (të re) nxanësin para stërvite me abeçetë e mbëdha të kapakut masandaj i hap thelbin.

BCSH

الصلاة والسلام

# Bilbil i Prillit

## ABETARE

### Për

### Bijat Mbesimtare

Femër, mashkull, vogël, i math, po thuaj si cili shqiptar
Ta mësojë gjuhën shqipe që të rojë mbesimtar
Se me anën e këndimit gjurmon besën e vërtetë
Kush leçit librat besare trashëgon më të dy jetë.

*Hafëz Abdull-llah Sëmblaku*

Hëna Dhil-Kade 1347. Muaji: Prill

بسم الله الرحمن الرحيم

# Bilbil i Prillit

Kur të të hyjë muaj i Prillit dëgjo Zërin e Bilbilit
Si të hapë giethi lule kundërmo prej trëndafilit
Po sa hyri muaj i Prillit vura në shtyp Abetarë
Këndon e thret vjershëria po me lot e me të qarë
Këndon e thret si Bilbili do të sqojë atdhetarë
I shtje themel diturisë si për bijtë mbesimtarë
Ay det i dashurisë kur ze e bën valë valë
Si trëndafil çelen vjershat tufë tufë, palë palë
Ç' është hiqmet kur vjen prilli ris avazë shpejt bilbili
Si nga ashku i Bilbilit ze qan edhe trëndafili
Me gjuhën e hakikatit këndon e thret vjershërija
Ka marë zjar si Bilbili do të zgjohen çilimija
Pjes e parë çiliminjvet para udhë j' u ka bërë
Po si kur të hysh më brënda e flak dr tën për të tërë
Mos i shëko vetëm cipën ce ka emrin Abetare
Vështro brënda të gjesh thelbin që ta njohç ti mbesimtare!
Jep dijën e hakikatit kjo: ta mbush kokën për jetë
Bjeri prapa diturisë që të kuptosh të vërtetë
Mer e puth e ver në ballë dhe këndoje dit e na'ë
Na jep rahmet edhe neve, mos na haro nga du-të
Kush e përflet shpesh Bilbilë, po më përflet edhe mua
Çpiksin para lavdëroje masandaj më bëj një dua.

# Bilbil i Prillit ç' na mëson?

Pjes e parë: Abetare dhe numurim
„ e dytë: Këndim edhe vjersha mbesim
„ e tretë: Jetë shkrim mi ca Zotërinj e Zotënesha (përhapja e Myslimanësisë).

# Vjershë mi vleftën e diturisë:

Ç' do njeri që ka me vehte atë dritën e mejtimit
E do pnna të mësojë për dijë veglën e shkrimit
Diturija, përfitohet në kohën e djalërisë.
Që të gatuash vëlla! tinë në kohën e pleqërisë
Ashtu edhe mir vetijat me kohë t' i përfitojmë
Me anën e vegël shkrimit veçan Fenë ta mësojmë
Jetim thuhet ay njeri që mbet pa mëm e pa bijë
Po asëll jetim të dihet cili mbeti në pa dijë
Pra: Mëso dijën e shenjtë me sa ke fuqin e vetë
Se kjo dritë të nxier ballë, të nderon më të dy jetë
Kush gëzohet diturisë, kush lëvdohet pasunisë
Po kamja një copë jetë mbetet në duar të njerzisë
E nis që në prak të djepit vazhdo gjer në buz të varit
Mëso diturin e shenjtë kjo fjal: e hazret Myhtarit.
Ajo dritë është shoqe nuk e le njerinë vetë
Kush kapi dijën e shenjtë trashëgon më të dy jetë.

# [Rabbi jessir, vela tuassir!] [Rabbi temmim bil-hajir!]

Shqip:

O Zot! të lutem: Ç' do punë ma lehtëso e mos ma rëndo. O Zot! prapë të lutem: punimin ma mbaro e ma përfundo përhajir.

## Para thënje

*Vëllezër mbesimtarë!*

Ç' do mbesimtar edhe mbesimtare e ka farz të mësojë diturin e fesë po e cila përfitohet me anën e vegël shkrimit, pra: Ç' do njeri po të vihet të mësojë ato 36 shkronjat shqip, në veglën e shkrimit hip.

Kjo libre është prezatitur me një mënyrë që ç' do mbesimtar si të mësojë lehtësisht gjuhën e vet, do të kalojë dhe në mbesimet e vërteta, do të marë pjesë dhe nga jetëshkrimet e ca shenjtorvet. Ç' do foshnjë po sa nis të flasë shqip, atrit mbesimtarë—fetarisht—detyrohen para ta stërvitën me besmele dhe me suretë e Kur-ânit masandaj me librat abetare, besare që japin ndjenja shpirtnore se me këtë mënyrë po të vendoset dashuri e këndimit, do të rënjoset edhe drita e mbesimit.

## Shkaku q' u nis kjo librë:

Në atë xhami të shenjtë që ndodhem Imam edhe Hatip, më vinin ca nxënëse për të mësuar Fe, si ju dhashë ca kohë për mëndash Fe edhe sure, më ardhi dë me ijtim t' u pregatit një libre abetare me të cilën nxënëseja si të mësojë gjuhën e vet dot këndojë edhe mbesimet e vërteta masandaj munt të lëçitë edhe librat e tjera besare si Mevlud, Hytbe e tij. Se bijat t' ona që do të bëhen mëma, me anën e shkrimit po të marim Fe, dot mësohen edhe bijt e tyre që dot vinë bres pas brezi sa jeta. Kjo detyr' e shenjtë i përket si atërvet myslyman ashtu tedhe djetarëvet të Fesë që qihen Imam d. m. th fëmijavet e mbesimtarëve ndë shqëpia a në xhami lipcet t' u apim mësim Fe edhe Kur-an, po dë ketë hakë më tepër j' u ep dorë të përkujdesen mësuësit, si kush detyrën e shenjtë le ta çmojë vetë, se prapa do të lerë një kujtim që të kujtohet rahmet për jetë. Neve me këtë qëllim po punojme. vell llahyl muvaffiku vel-myrshide H. Abdulli il

Shkronjat e shtypit të vogla

a b c ç d dh e ë f g gj

h i j k l ll m n nj o p q r

rr s sh t th u v x xh y z zh

---

Shkronjat e shtypit kryesore

A B C Ç D DH E Ë F

G GJ H I J K L LL M N

NJ O P Q R RR S SH T

TH U V X XH Y Z ZH

BKSH

Shkronjat e dorës të vogla.



Shkronjat e dorës kryesore.

Brisht

Shkronjat prapkëthi.

zh z y xh x v u th t sh s rr r q p o nj
n m ll l k j i h gj g f ë e dh d ç c b a

Shkronja të përzjera.

b d n f z j o ll r i l t sh p c
ë a g q th h ç m y rr s u v x nj
zh gj k dh e xh

Shkronjat zanore.

**a, e, ë, i, o, u, y, (1)**

Shkronja të ngjitura:

ba, be, bë, bi, bo, bu, by, ca, ce, ci, co, cu, cy, da, de, dë, di, do, dy, fa, fe, fë, fi, fo, fu, fy, ga, ge, gë, gi, go, gu, ha, he, hë, hi, ho, hu, hy, ka, ke, kë, ki, ko, ku, ky, la, le, lë, li, lo, lu, ly, ma, me, më, mi, mo mu. ab, eb, ëb, ib, ob, ub, yb, aç, eç, ëç, iç, oç, uç, yç, ah, eh, ëh' ih, oh, uh, yh.

1) Shkronjat e tjera që mbeten 29 quhen bashkë zanore të cilat pa zanore nuk munt të flitcn.

Shkronja të ngjitura po të përzjera:

ab, af, ag, aj, all, ash, ak, an, al, ad, ar, aç, ba, ga, fa, ja, lla, sha, na, la, ka, da, ra, ça, ca, eb, eg, ej, oj, uj, ell, esh, ek, en, el, ed, er, eç, dha, dhi, sa, su, ma, na, qa, pa, xha, za, ze, xha, xhe.

---

Shkronja të ngjitura më trish e më katër:

bra, bre, bri, bro, bru, bry, ndra, ndre, ndri, ndro, ndru, ndry, zbra, zbre, zbri, zbru, zbry, ngra, ngre, ngri, ngro, ngru, ngry, shtra, shtre, shtri, shtro, shtru, shtry, mbra, mbre, mbri, mbro, mbru, mbry, ntra, ntri, ntro, ntru, ntry, shkra, shkre, shkri.

---

## fjalë:

ba-ba, tu-ba, do lla, da-le, va-la, ma-li, gje-li, më ma, a-ti, un-gji, vë lla, mot-rë, da-i, ha-llo, te-ze, kush-ri, sy-ri, do-ra, e ra, u ji, fi-qi, tu-fa, fu-sha, pe-ma, llam-ba, dri-ta, mble-ta, shpa-ta, sha-ta, dru ri, tra-ri, bre-zi, fre-ri.

---

dja-thi, gjal-pi, gje-lla, spinaqi, mbanja, dil-nja, shih-nja, zbavit sha, shkruanja, mbre-nja, mbill-nja, ngje-sha, mve-sha, shtrova, mbo-lla, qëllo-va, mbe-sova, puno-va, lulë-zonj, për-pa-ronj, trashë-gonj, kë-shi-llonj, kundër-monj, vizitonj, mëshironi, ndih-monj.

## Stërvitje:

Bil-bil, trën-dafil, prill, flori, fillo-re, bagëti, shpe-shëri, mizë-ri, qëllim, mbesim, punim, lulë-zim, për-pa-rim, trashë-gim, xhami, minber, mihrap, mina-e, qabe, meqqe, medine, mus-haf, kible, qi-tap, mela-iqe, fe mëmë-dhe, rah-met, xhen-net.

---

| | (një faqe llogari) | | shkurtazi. | |
|---|---|---|---|---|
| 1 | 16 | 28 | 105 | 200 |
| 2 | 17 | 29 | 106 | 300 |
| 3 | 18 | 30 | 107 | 400 |
| 4 | 19 | 40 | 108 | 500 |
| 5 | 20 | 50 | 109 | 600 |
| 6 | 21 | 60 | 110 | 700 |
| 7 | 22 | 70 | 120 | 800 |
| 8 | 23 | 80 | 130 | 900 |
| 9 | 24 | 90 | 140 | 1,000 |
| 10 | 25 | 100 | 150 | 10,000 |
| 11 | 26 | 101 | 160 | 100,000 |
| 12 | 27 | 102 | 170 | 1,000,000 |
| 13 | 28 | 103 | 180 | |
| 14 | | 104 | 190 | |

java ka 7 dit.
muaji ka 30 dit.
moti ka 360 dit.

dita edhe nata kanë 24 orë.
ora ka 60 dakika (minuta).

(1) Stërviti mbarë, prapë e të përzjera.

BKSH

Ditët e javës janë këto: e Enjte, e Premte, e Shtunë, e Djelë, e Hënë, e Martë, e Mërkurë.

Muajt e motit janë 12:

1 Marsi ka 31 dit
2 Prilli ka 30 dit
3 Maji ka 31 dit
4 Qershori ka 30 dit
5 Korriku ka 31 dit
6 Gushti ka 31 dit
7 Shtatori ka 30 dit
8 Tetori ka 31 dit
9 Nëntori ka 30 dit
10 Dhjetori ka 31 dit
11 Kollozheku ka 31 dit
12 Shkurti ka 28 dit here 29

| | | | |
|---|---|---|---|
| shenja | mbledhje: | + | numrat i mbleth |
| „ | zbritje: | − „ | i zbret |
| „ | shumëzim: | × „ | i shumëzon |
| „ | pjesëtim: | : „ | i pjesëton |
| „ | njëhësim: | = „ | i njëhëson. |

Falja e Sabahut ka katër reqat: $2+2=4$, d. m. dy synet e dy farz, vleja ka 10 reqat: $4+4+2=10$

mbledhja behet edhe keshtu:

| | | |
|---|---|---|
| 8 | 18 | 100 |
| 4 | 14 | 200 |
| 12 | 32 | 300 |

Moti ka 12 muaj sa kemi lënë? $12-2=10$.

7 okë gjalpë për nga 7 korona sa bëjnë? $7\times7=49$.

(2500) korona pjesëtoji për dy veta: $2500:2=1250$.

Librat e veçanta numurtore, tregojnë më gjër e ujalë. Kush dëshëron eçit edhe ato libra.

BKSH

## (Pjes e dytë: Këndim edhe mbesim).

Bilbili, është një shpesh fluturak, kendezi quhet një shpesh shtëpjak kur këndon bën: kukuriku ! ! !

Këtu duhet të gjykojmë edhe kryenë d. m. th. këndezin (ose çiftet e para) kush i çpiku? Kur i vjen koha kush e përflet? se Zoti me të math vetë ç' do kafshe i fali një fuqi të veçantë, këndimin e shpeshërisë tjatër kafshë s' e bën dot, qumështin e bagëtisë tjatër kafshë s' e jep dot, punën e kalit e të buallit tjatër kafshë se heq dot, mjeshtërinë e njeriut as një kafshë s' e kryen dot, po si kush me atë fuqi q' i fali Zot i vërtetë munt të mbarojë vetëm detyrën e vet, mbleta është një mizë që na jep mjaltë e cila në kosh të saj ngreh një mjeshtëri që habiten gjithë njerzija. Këtë mizë vallë kush e mësoj? stërgjet, dëllëndyshkat që quhen veranake, në verë vinë këtu, në dimër ikin në viset e nxehta, po kohën e dimrit edhe viset e nxehta ku i dinë? vallë kush ja u tregoj, si ç' do njeri edhe kafshë, për fëmijën e vet, ka një mëshirë të cilën kush e dhuroj? të gjitha këto që shohim në jetë, dëshmojnë plot fuqinë edhe holl mjeshtërinë e Zotit me të math vetë.

---

(1) pjes e dytë këndim edhe mbesim, më ca vise e hi ngrehur me vjershërim, se vjersha, këndimit i jep një shijë të veçantë të cilat nxënësi i mëson edhe përmëndash, më ca vise janë ngrehur me pyetkë e me përgjegje që të këmbejnë fjalë dy palë nxënës.

## Vjershë:

Me veglat që ngrehu ky njeriu në botë
Mos u habit tinë shih fuqin e plotë
Se sa mieshtërira që ka qitur ropi
Jan nga drit e mëndjes që ka falur Zoti (xhel le) (1)
Dritë më të madhe dha mëndjen e zjartë
Vegël më të madhe dha krahët e duartë
Me këto fuqira kafshët i urdhrojmë
Lloje mieshtërira në botë tregojmë.
Mos u habit vetëm me duart' e njerzisë
Se është mëndje falsi çpiks i giithësisë.

---

## Të mirat e jetës kush na i falë?

## vjershë:

Kuajtë janë për të hipur nëmërohen shtëpijakë
Shpeshërija që këndojnë nëmërohen flulurakë
Bagëti quhen dë shqipet lopa, delja, edhe dhija
Që marin lesh edhe qumësht veç prej syresh njerëzija
Prej qumështit nxi rin gjalpë, djathë, gjizë e të tjera
A po me lesh nuku mveshim edhe shtrojmë gjer de dera
Drurët japin gjithë pemë, toka po jep gjithë bimë
Më ca vise ka metale, më ca vise ka mburimë
Trup i djellit mi të tërë qysh e përhap atë dritë?
Shëko fletën si këthehet, ajo nata bëhet ditë
Po pra si kur të mejtojmë kush i fal këto të mira?
Kafshërinë, shpeshërinë pas'ai kaqe mizërira,
Mos i shëko vetëm shkrimet që sheh të çpikur në botë
Gjej shkronjsin edhe krijonjsn se ky shkrim po ta thotë

(1) Kur shkruhet ose kur kujtohet emri i të madhit Zot për nderim thuhet: (xhel-le xhelaluh) ose (me të math vetë) Kur kujtohet ose shkruhet emri i të mirit pejgamber jepet salevat ose thuhet: alejhissalaty vesselam.

Pa një shkronjës atë shkrimin a ta mbeson njeri vallë?
Pa një çpikës edhe bota kështu spranohet pa fjalë.
Ay Zot mëshirë plotë tër' i fali për njerinë
T' i bëjë shyqyr me gojë t' i japë dhe robërinë
Është veç për fuqi madhin o vëllezër' madhërija
Për neve po ësht e dreqtë me krye nnjur robërija
Ç' do njeri që vjen në botë e do puna të menjtojë
Ç' është kryeja edhe fundi menjtimin ta lartësojë
Ce dha dritën e menjtimit, masandaj veglën e shkrimit
Të menjtojmë, të gjykojmë dë rugën e njerëzimit
Jemi bijtë e Ademit veç një Zot na ka krijuar
Po si kundër kemi erdhur kemi edhe të ndëruar
Prapdaj duhet ajo besë, faqe bardhë që të vemë
Në jetën që s' ka të sosur dë xhe-net meqan të zemë.

---

## Vjershë

Jam një bijë mbesimtare (1) e pohoj me gjuhë vetë
Nuk e haronj fenë fare sa të ronj në këtë jetë
Si ç' po them këto fjalime, dëshmon edhe zemra ime
Do ta mbanj besën e babës që më riti me thërime
Se me një fe të vërtetë është nderja e njerzisë
Pa një besë, pa një dritë është shkall e bagëtisë
Jemi një trup e një rënjë, kemi një at e një nënë
Kemi një gjuh e një besë, dë një vatan kemi rënë
Me anën e diturisë do ta mësonj mirë fenë
Që ta di ç' duhet mbesuar ta njoh edhe mëmëdhenë
Pra e mbesonj fuqi madhin është një e i vërtetë
Muham-med Resulull-llahu i dërguar në këtë jetë
Fe kam myslimanësinë qitap: hazreti Kur-anë!
Kible kam vetëm Qabenë, din vëlla kam myslimanë.

---

(1) mashkulli thotë: jam një bir prej mbesimtari

# (Mi mbesim një vjershë ball për ballë)

## në mes të dy palë nxënësvet:

Pyet: A nuk më thua vëlla (1) tinë ç' ka erdhur njeriu në jetë?
Ç' është shkaku i krijimit, ç' është ruga e vërtetë?
Përgj: Dëgjo vëlla! njeriu erdhi të dijë vehten e tija
Të njohë besën e Zotit edhe ç' është robërija
Se shkaku që u krijuanë çpikjet edhe gjithësija
Të dihet, të lavdërohet ku do vetëm plot fuqija (1)
Pyet: A nuk më thua për mbesimet qysh i mbeson këto vallë?
Radhitimi edhe punimet, s' është feja veç me fjalë.
Përgj: Para mbesonj të math Zotin, masandaj melaiqetë
Qitapët dhe pejgamberët janë hak e të vërtetë
Mbesonj ditën e pastajmë, kur të marë funt kjo jetë
E mbesonj edhe Kaderë që e çpik i madhi vetë
Punim është shehadeti, prandaj falja agjerimi
Kemi Haxh' edhe Zeqatin me këto shtohet mbesimi
Kush e punon mirë tokën do të marë pra: kallinë
Kush e punon edhe besën e shton myslimanësinë
Pyet: A nuk më thua mir vetijat cilat lipcen për njerinë?
Se këto e plotësojnë ca më mirë robërinë
Përgj: Dëgjo vëlla! të mbash mirë me gjith robët dashurinë
Dë zemër të kesh mëshirë, e bëj zakon urtësinë
Dë kanaet të kesh pjesë, durimin e ki fortesë
Bëju edhe dorë gjatë se të shtohet ajo besë
Vështro mbaj vehten të posh.ë mos e haro turpësinë
Dë fjalët ki besa besë, dë zemër mbaj trimërinë
Menjto hollë pastaj folë sa të munç e mbaj pushimin
Të bësh shyqyr dit e natë, mos e bëj zakon ankimin

---

(1) Bijat shoqe, po të këmbejnë fjalë thonë: motrë! po **plaku me nxënësin** a me nxënsën përdorin thirjen: o bir, bijë. Nxënsi përgjegjet: **dëgjo zotni!**

(2) Zoti me të math vetë që është çpika i gjithësisë.

Bëj teveqyi veç de Zoti kërkoji rëzkun e gjërë
Mos unq kokën ti de ropi se krijonjsi i ngop tërë
Shërbe për din, për vatanë u bëj si trim si i çkafur
Lere rahatin më njanë shëko puno me sy hapur
Se kështu bëhesh i dashur de Hakku, de njerëzija
Të nderon më të dy jetë ta dish vëlla! mirvetija
Pyet: A nuk më thua mjeshtërirat a lipcet ti sqojmë vallë?
Se vatani kërkon punë nuku mbahet veç me fjalë
Përgj: Po po vëlla! mjeshtëtirat e do puna t' i mësojmë
Po para të hapim dijë, vatanë ta lulëzojmë
(*E lyp koha të këndojmë gjithënjë librat besare)
(Se mer dritë ajo zemra nuk e haron fenë fare)
*Masandaj me mjeshtërira vatanë at përparojmë
Si e lyp koha, neuoja ato masa t' i gatojmë
Dë pazar të mjeshtërisë duhet veçan drejtësija
Se kush e mban këtë dritë i përparon tregëtija
Të mirën që do për vehte t' ja duash dhe vëllazërisë
Yshqe qëllimin e mbarë veç bëj mirë njerëzisë
Kush i mban këto që thamë faqen e zhardhi për jetë
Esht i dashur de njerëzija trashëgon më të dy jetë

---

## Mi vleftën e diturisë një vjershë ball për ballë

Pyet: A nuk më thua vëlla! tinë ay nur i gjithësisë
Ç' urdhron vallë me hadithe mi vleftën e diturisë
Përgj: Po të dëgjosh vëlla! tinë fjalën e hazreti Muhtarit:
Kërko dijën që nga djepi gjer të vesh dë buz të varit
Prapë tha i miri jonë; gradoja e diturisë
Kalon mi të tërë gradot e nalta të njerëzisë
Prapë tha i miri jonë: kush kërkon dijën e naltë
E kërkon edhe xuen-neti nuk e le atë në baltë
Pyet: A nuk më thua edhe pakëe fjalët e Imam Alisë
Ç' urdhëroj mi vleftën e Dijës ajo port e diturisë?
Përgj: Urdhroj tha Imam Alija: kush më shet me shkronjë mua

Më bën rop mua të mjerin, atë njeri fort e dua
Urdhron Zati Ahmedija: Iam qytet unë ne dija
Është port e diturisë ta dini Imam Alija
Po kjo dijë që lëvdohet është dija e vërtetë!
E jo veç cipa e botës a sa metal ka në jetë
E jo antrikat e botës që grabitin njerëzinë
Po dija e drejt menjtimit që e ndrioin gjithësinë
Pyet: e kuptova vëlla! unë se sa vlefë paska dija
Po nuk më thua më sa lloje ndahet kjo: de njerëzija
Përgj: Diturija para ndahet më dy lloj o i uruarë!
Rahmani quhet një dijë, tjatra është e turbullуarë
Gjurmo diturin e mbarë që e pranon njerëzimi
Të ruhesh nga dij' e turbull se të prapsohet menjtimi
Nga kjo dijë pjell sëmundje veçan ay vet pëlqimi
Nga ky shkak shohim ca njerës largohen nga drejt menjtimi
Po nga dija e kulluar nurojnë gjith mir vetija
Sheh hajr dini, vatani edhe gjith vëllazërija
Pyet: Diturija e kulluar më sa degë është ndarë
Më e para cila është provoma vëlla i mbarë!
Përgj: Diturija që pyet tinë ndahet vëlla disa pjesë
Para dija e vërtetë veçan dituri e Fesë
Se kjo dijë është e **Zotit** na ndriton më të dy jetë
Kamja, gjëja do të lihen veç kjo: shoqëron për jetë
Pra: lëçit librat besare shpirti, zemra të ndritohet
Mëso dijën e vërtetë në do mëndja të drejtohet
Pyet: Po mbas libravet besare cilat libra të kën lojmë
Që dijën gjith me këndime për herë ta përparojmë
Përgj: Si të kuptosh para fenë edhe ç' është drejtdsija
Pajtaj lëçit ato libra (1) që kallzojnë mir vetija
Si të mësosh mir vetijat lëçit edhe istoritë
Se mer pjesë nga të parit të mbushet koka me dritë

(1) ilmi ahlak

Istorin e pejgambervet këndo të març të vërtetë
Si ka rjedhur oun e botës ta çkoq e të ndrit për jetë
Jetshkrimin e dijetarvet këndo dhe të mbretërisë
Istorin e mbesimtarvet veçan jetën e njerzisë
Kush punoj e derdhi trupin si për din e për vatanë
I jep rahmet gjithë bota veçan ist ritë ç' janë
Si të këndosh istoritë munt të hapish xhagrafitë
Mëso tokën edhe botën pastaj gjithë njerëzitë
Njeh vëllazrit myslimanë gjer ku vallë jan zgjiruar?
Gjykon dhe kombet e tjerë me se kanë përparuar?
Lëçit edhe Kozmografin që të kuptosh yjtë ç' janë
Sa Djellë ka gjithësija, ç' ka më qej dhe an' e mbanë
Që të kuptosh madhërinë, të lavdërosh plot fuqinë
Të vesh kokën de sexhdeja, të bësh ispat robërinë
Të tipcet edhe hesapi numërtore që i thonë
Se me këtë hesaposen nevojat e rojtjkës t' onë
Janë me dijë më vehte tregëtija, bujqësija
Duhet me sistem të fundit veçan ajo mjeshtërija
Kemi edhe shumë degë po të cilat s' munt të thuhen
Gjer tani kallzuamë neve cilat më lepër na duhen
Të cilat po të fitohen veç me një qëllim të mbarë
sheh bajir dini, vatani edhe ç' do vëlla i mbarë
Para kap dijën e shenjtë që të ndritohesh për jetë
Mos hyrë dë turbullirat se largon nga rug e drejtë
Jepi mësim para çunit me mësimet e vërteta
Që të marë prandaj radhë të çfaqet për të e drejta

(Librat edhe shkollat (fetare) që përhapin misjonerët në botën myslimane, janë më farmaq, se të cilët me këtë veglë qëllojnë të çkatërrojnë mbesimet e myslimanvet po dë syt e botës tregohen dijë hapës, mirëbërës, me këtë qëllim kanë bërë shoqërira edhe derdhin grosh me miljarë. dë Egiyptë (Misir) italjanët për bijat myslimane kanë hapur shkolla në të cilat ka myslimane me padijësi që vazhdojnë edhe mësojnë zeheret e huaj. athere dijetarët edhe kryetarët mysliman që janë në botë ç' po bëjnë e

ç' po presin? bijtë edhe bijat m sliman q' i kemi në duar emanet ce i lemë në dor të huaj? ce të mos përpiqemi ti zgjojmë vetë dyke përhapur libra besare edhe kambtare që të yshqehen me dashurin e Fesë e të Mëmëdhesë, si kush detyrën e shenjtë lipcet ta gjykojë e ta çmojë vetë.)

## Mirë Shkrim

(Mëso të shkruash shkrim të mirë se kjo: vëlla! të shton ndorië). (Po ka dhe një lehtësirë shkakëton vëzkun e gjerë.) (Kush mëron shkrim të kultivar shtohet dhe nga dashurija) (Se i jep një shijë tjatrit prush kënagen njerëzija).

## Dë një mbledhje Mevlud, këmbim fjalë dë mes të dy palë nxënës a nxënësevet

**Pyet:** A nuk më thua vëlla! tinë ce u mblothmë këtu vallë?
E për sa ishte qëllimi ç' u këndua në ato fjalë?
**Përgj:** Ky ishte Mevlud i shenjtë që lëvduamë nur serverë
**Zot** i jetës na i zgjithtë ta këndojmë gjith për herë (1)
Se është i madh i botës dhe Sulltan i zjithësisë

(1) dë një mbledhje Mevlud, para fillon Imami ose Mevlud këndonjsi, do për të shtuar dëshirat besare edhe shpirtnore thriten edhe ca nxënës që të këndojnë Mevlud së bashku me një zë Si mbaron Mevludi mi nderimin e Mevludit para Xhema-atit munt të këmbejnë edhe fjalë me këtë vjershë të gatuar po të cilët më këmbë disa çape lark balli për ballë do ta këmbejnë me një dëshfrë të plotë e me një zë të squar përmëndash.

E do puna ta nderojmë të madhin e njerëzisë
Pyet: Ç' u këndua para Mevludit masandaj vallë ç' dëgjuamë?
Cila dritë bëri valë veçanërisht tani thuamë
Përgj: Ish ajeti qerimeja që filloj vëllal më parë
Salavati sherifeja e stolisi këtë barë
Prapë filloj Ziqrull-llahu me një gojë të uruarë
Masandaj Resulull-llahu me radhë është lëvduarë
Gjettë rahmet Mevlud shkroj i që na la librën e shenjtë
Se prej saj dritë po marin si të rinj e të mbëdhenjtë
U kujtuanë Sahabeja veçan edhe ehli Bejti
Se kur kujtohen të mirit nuron atje veç rahmeti
U fol shkaku i krijimit edhe puna e gjykimit
Masandaj hymë dë lindjen e mbretit të njerëzimit
Kur mbaronte fjal e lindjes e sulltanit të dërguar
Para u ngritmë më këmbë dreq kiblesë të drejtuar
Çuamë salat nur serverit me gjith nderimet e plota
Se kështu do të nderohet gjer të marë funt kjo bota
Dë Minare si lëvdohet shëshit pesë her në ditë
Dë Mevlud do të nderohet ca më tepër ajo dritë
Pyet: Prandaj dë Mevlud ç' kujtohet pa na i çkoq gjër e gjatë
Të dëgjojnë atrit t' anë veçan mëmat edhe gratë
Përgj: Mbas lindjes kemi gëzimin qysh e çpalli gjithësija
I vjen radha të kujtohet masandaj Miraxh i tija
Mbas kësaj tregon Mevludi qysh ndëroj sulltan i fesë
Këndon e qan vjershërija me vdekjen e Zatimesë
Tregon hazreti Halilë qysh bëri kurban të birë
Po i biri Ismaili si e pranoj me dëshirë
I hyri me lot pëllumbi dë pëqi Resulull-llahut
E mprojti i miri jonë sa me thikë i ra krahut
Pastaj ndreja dhe deveja qanë hallë de Serveri
Bëri derman dhe për kafshët se ashtu ja deshte nderi
Pra: për vleftën e Mevludit dy ngjarje janë kujtuar
Se fundi e mbyll duaja Mevludin e shenjtëruar!

## (bijavet ca mësime fejake)

Për të mbajtur rojtkën t' onë edhe vatanë t' onë me nder, lipset të gjitha mjeshtëritë t'i mësojmë po femra kur arin në moshën 7 vjeç e lart, dut mësojë mjeshtërirat e brënçme të grave si dhe veglat, maqinat e tij, (1) mashkulli kur arin shtatë e lart e do pra të mësojë mjeshtërirat e jashtme të meshkujvet se me këtë mënyrë rojtk e njerzisë vjen në mbrothë. Këto detyra s' është e drejtë të çkëmbehen ose vetëm njërit t'i ngarkohen.

Bija mbesimtare kur arin në moshënë e martesës e ka farz edhe mbulesën se me të cilën kundrejt të huajvet mpron nderë edhe turpësinë, urdhron i dashur i Zotit: (turpësija vjen nga drita e mbesimit) po kjo mbulesë duhet me një mënyrë të nderçmë si qëeriton për një mbesimtarë, se petkat e përjashtme ose shares po të jenë të stolisura a të hapta që të ndjellin syt' e botës, janë gjynah edhe haram, mbulesa duhet me një çeshit që të mprosh nderë nga të huajtë. Musafehaja (toka) që përkim dorie është syn-eti sherit, po gruaja me gra ose burri me burrë, jose një grua mbesimtare, me ata të huajtë që s'i ka gjak edhe farë e fis, fare toka s' mund të bëjë, (2) myslimanësija, këto zakonet e të huajvet na i ndal-n krejt myslimanët e parë që punonin me sheri-at e si mbas qitapit Kur-an, në të dy jetë trashëguanë, të cilvet po t' u apin rahmet gjithë bota edhe istorija, për të marë një shembëll tani do të tregojmë jetëshkrimin e ca shenjtorvet që kanë dalë me famë në botën myslimane.

---

(2) Vetom se me vëlla, kushri, daji, ung edhe djemtë e tyre

(1) veçan veglën e shkrimit si kush mbesimtare mbas këndaj lipset ta mësojë se me të cilën Fenë që ka fara do ta kuptojë, se në kohëbet e qytetëruar nuku gjen dot njeri që të mos dijë shkrim edhe këndim, që të gjithë Fen e vet edhe gjuhën e vet e kanë mësuar mbas çpenëm? Kush mëson trashëgon.

# Pjes e Tretë: Jetëshkrim mi ca Zotrinj e Zotnesha. (Mëmat e Mbesimtarëvet)

## Veçan përhapja e myslimanësisë (hazreti Amineja e bij e vehebit)

**"Qoft e lumtur më të dy jetë.**

Hazreti Amineja, është mëma e hazreti pejgamberit t' onë "Muham-med Mustafa" alejhissalaty vesselam.

Gjysh i të mirit pejgamber Abdvl-Myttalipi, hazreti Aminenë e kish marë-me niqah-për të birin Abdull-llah edhe prej syresh hazreti Muham-medi ka erdhur më dynja. Nur i fjesht i Resulull-llahut që kish rjedhur nga baba Ademi, po llapste në ballën e hazreti Abdull-llahut të cilën disa gra të nderçme e kërkuanë po ky kësmet j' u bë nasip Aminesë, atë mot që ra në barkun e mëmës i miri pejgamber, kaqe bimë e bereqet është bërë sa tërë Arebija u bënë kamës me të tepër të cilët këtë motin e uruar e qojtnë, senetyl-fet hi, vel ibtihaxh, d. m. (mot i mbarë e i gëzimit) kur qe hamile hazreti Amineja, i shoqi i miri Abdull-llah u sëmur e në moshën 25 vjet dë Medine ndëroj jetë, pra: i miri pejgamber mbeti jetim po më datën 569 të Isevisë, në Mëqqe i myqerreme lindi me një nderim të math, në muajin Prill e në hënën 12 Bebiul-evvel, kur ka lindur i miri pejgamber, gjithësija u bë nur, nur i fjesht i pejgamberisë që kish llapsur në ballën e Abdull-llahut e të Aminesë, tani ç' këlqeu në ballën e hazreti Muham-medisë.

(Tani gjeti vëndin nuri Ahmedija
Nuri që kish rjedhur që nga Ademija
Me gëzim të madhe thirë nga ç' do anë:
Misardhe, misardhe! nur i Zotit thanë)

Hazreti Amineja ka thënë: unë kur linda këtë foshnjë të mbarë, nuk pashë mundim fare po vetëm dëgjova një zë: (ti e dashur Amine! ta dish se tinë me atë të madhin e botës je hamile, kur të lindë e quaj: (Muham-med) kur afroj koha e lindjes më ardhi një shpesh i bardhë e më shtrëngoj, më tjatër anë më sualli një sherbet të cilen kur e piva, nuri krejt më mbuloj.

(Kur e mbuloj ay nuri ka lindur ay sullltan!
Jepi vëlla! me gjith zemër: essalaty vesselam!)

## Vjershë lëvdim.

A e di bajram e parë kur e bënë gjithësija?
Kur lindi si nur i fjeshtë dë Meqqe Resulull-llahu!
Djell i fsheht' i Ademisë kur doli nga Arebija
Ngaj gëzimi alurinin: mise arth Resulull-llahu!
J' u dha fundin që të lëvet zati paqi Ahmedija
Esht i madh i pejgambervet ta dish ti Resulull-llahu!
Ç' ka me dhe, më qell të naltë u çpik për nderin e tija
Mer një masë vëlla! tinë sa i math Resulull-llahu!
Ç' janë ndrydhe edhe hupa uruanë Zotrin e tija
Se rahmet për gjith ale aët u dërgua Resulull-llahu!
Në dytim, në eresirë kishin mbetur njerëzija
Ardhi koha që t' i nxierë dë njëjtim Resulull-llahu!
Jepi salaty selamin në do ti ndihmën e t'ja
Shefa-at për ne të mjerit dot bejë Resulull-llahu!

Kur ka lindur i miri pejgamber, gjyshi Abdyl-myttalipi, në qabet-bënte ibadet, po kur i ardhi një zë: (myzhde ja Abdyl-myttalip! se tani prej Aminese lindi një foshnjë e uruar që dot jetë rahmet për gjithë ç' janë krijuar) i miri pejgamber lindi synet-li edhe me këthizë

të prerë po (kundrejt zemrës) në kuris prapa mes supavet kish një shënjë të veçantë q' i thohin: Hatemi nybyvvet (vul e pejgamberisë).

(Me ca pulla sa një qiqër reth e rotull ish stolisur
(Muham-medyn Resulull Ilah) emri shenjtë ish qëndisur
Kur ja shihnin dijetarët atë shënjën e uruar
Lajmëronin njerëzinë: ky dot bëhet i dërguar)

Abdyl myttalipi kur pa këto sihariqe të mbëdha, qe gëzuar me të tepër, si i bëri Zotit shyqyr edhe sexhde, gatiti një gosti të madhe në të cilën e ftoj gjithë kombin e Meqqesë, si u ngopnë i thanë: atë foshnjë që shkakëtoj këtë gosti ce e qojte Muham-med? j' u përgjeq: (njerëzija dhe melaiqetë do ta lëvdojnë më të dy jetë). Kuptim i këti emri është: (njeri fort i lëvduar) me vërtet si më qell ashtu e në feqet të dheut Zotri e ti po kujtohet sheshit nga pesë her në ditë. Shqiptar merhum Abidin pashë Çami që dinte disa gjuhë, në librën mesnevi thotë: (në një Inxhil emr i pejgamberit t' onë ësht kujtuar me gjuhën greqisht kështu: (mbas meje vjen Priklitosi) fjala priklitos dë asllit ka qënë Paraklitos e cila jep kuptim: (njeri fort i lëvduar) kuptohet se emrin e pejgamberit tonë "alejhisselam" po e shinojnë gjith qitapët e qellta.)

I miri pejgamber dë vogëli ka pirë qumësht prej Halime Sadijes e cila mëmë këtë foshnjë e dashuronte më tepër se bijt e saj, se me të marë këtë foshnjë kish pikasur mbarësi edhe mrekullira të çudiçme si e riti gjer më katër vjeç, hazreti Aminesë ja dorëzoj prapë, po atë mot hazreti Amineja ndëroj jetë pra: kjo foshnjë mbeti jetim edhe nga mëma, (1) pastaj e riti gjyshi Ab-

(Hazreti Amineja kur ndëroj jetë kish thënë: rata që rojnë do të vdesin, ç' do gjë ere vjetërohet, ç' do vent që duket do të mbarohet edhe unë do të mbaroni, po emri im gjer më kijamet dot kujtohet se unë solla një hajirli evlat që do ta lëvdojnë gjithë bota.)

dyl-myttalipi, më tetë vjeç e ka marë ungji Ebu-talipi që ish baba i Imamit Aliut. Hazreti kur hipi në moshrat e lartra me mirvetija dhe me drejtësira-kaqe u bë i ndjerë e i mbesuar sa në mes të kombit u qojt: Muhammedyl emin (i dreqtë i mbesuar) po kur'i ardhi pejgamberllëku më 40 vjet, kombin zu e ndalonte nga ato patet që qenë ngrehur me duar të ropit edhe i ftonte dë njëjtim të Zotit athere kombi i Meqqesë që qenë argasur me zakonet e para u rënduanë.

(Me zakon pas qefit njeriu kur argaset
Pastaj s' i ka kënda de fe a të nqaset
Kështu kur argasen edhe pa fesija
Një zakon j' u mbetet pastaj qesëndija
Mos u habit tinë me ca që lëvdohen
Të nëncëm, të ditur hiqen e tregohen
Se vehtë pëlqimi i heq të pengohen
Prandaj nga të tjerit më tepër verbohen
Pandehin me llustër shtohen dituritë
Po është në zemër vëllai ajo dritë
Drit e Hidajetit a'i që t' i vijë
Atë nur e Zotit ay dot arijë.)

I miri pejgamber kombin e ftoj në besë, po të pak njerës muarë pjesë, nga gratë më parë mbesoj hazreti Hatixheja, nga pleqtë hazreti Eba-beqiri, nga djemtë Imami Aliu, i dyzeti është i miri ymer "radijell-llahu teala anhym" kombi Meqqe përveç se që nuk mbesonin po edhe mbesimtarët i mundonin teper, pas disa vjet nga Medineja na vinë ca medinasë tregëtarë të cilët në Meqqe kur i pjek i miri pejgamber j' u këndon pak Kuran edhe i fton të bëhen mysliman. Medinasët prej dijetarvet të Medinesë kishin dëgjuar se ay pejgamber që lajmëron Tevrat edhe Inxhili po vjen e po afron pra: në atë ças u bënë mysliman, po si vajtnë në vatan, ca nga ca kambin e Medinesë e gualle dë Iman tërë, pas

pak kohë nga Medineja ngrien 75 veta mbesimtarë të piqen me Resulull-llahun, si u çmallosnë me të mirin pejgamber u fjalosnë edhe për hixhret. (1) medinasët kur dhanë besa besë për din-që do të bëhen kurban, i miri pejgamber i përgëzoj: në jetën e pa sosur çpërblim do të keni xhen-net edhe Rridvan! masanëaj sahabevet j' u dha lejë të cilët kur bënin hixhret dë Medine, medinasët-me gëzim të math i nderonin, e në vatan të tyre-si vëlla-i pjesëtonin, me këtë shërbim të math që treguanë për miqtë e dashur, Medinasët u qojtnë: ensarë (ndihmëtarë) për din ata që lanë vatanë e qojtnë: Muhaxhirë, prej të dy palvet Zot i vërtetë qoftë razi se trimëri e tyre nuk munt të çmohet as me gjuhë as me pendë më pra i miri pejgamber bashkë me Eba-beqirë kur urdhruanë dë Medine, medinasët kaqe u gëzuanë sa atë ditë u bë një bajram që nuku është bërë në jetë kurrë.

## (vjershë)

Dë rugat e Medinesë qenë derdhur djejmulija
Ngaj gëzimi alurinin: po na vjen Resulull llahu!
Dhe mi kulmat e shtëpivet kishin hipur graulija
Po e prisnin atë djellë që pa hapur mir sabahu!
Si ngaj do që të shëkonje po valonte vjershërija
Me lëvdime gjër e gjatë ce kondish i mir Shahu!
Ngaj gëzimi po këndonin sa ishin dhe shpeshërija
Po bilbili bënte ballë që me Sehar më shpejt rahu!
Mise ardhe, mise ardhe! po i thrisnin gjithësija
Për rahmet, për udhëheqës të dërgovi ty All-llahu! (xhel-le)
Po si kush ngaj medinasët stolisur shtëpin e tija
Me një shpresë se mos zbresë dek' unë Resulull-llahu!
Po deveja vet kondisi de Halidi ensarija

(1) Per të urdhruar Resulull-llahu ure gjith sahabe, dë Medine.

E ka pritur atë hënë ky i lumtur zën për krahu!
Ashtu bajram edhe festim s' kish parë njerëzija
Ngaj gëzimi qanin sytë kur hynte Resulull-llahu!
Për ashkun e nur sulltanit po të qajë Ademija
Një pik lot bëhet sa deti, me lot, zjarë e shuan ahu!

Me kondisjen e Resulull-llahut Medineja u ndritua, u madhua, u trashëgua tepër masandaj myslimanësija ca nga ca u përhap në tërë tokën Arebi, po në kohën e halifatvet u zgjerua gjer në Persi, Greqi, Palestin, Egjyptë, masandaj shkrepëtiu në Çin, Hindi, Okjani, Afërikë. Sot lavdi Zotit-dë faqet të dheut-jemi afër (400) miljon myslimanë (1) të cilët detyrohemi t' u apim rahmet atyre sahabeve ndjerë që bënë shpirtin edhe gjënë kurban për besën e Zotit dhe për neve robët e mjerë.

"ridvanull-llahi te-ala, alejhim exhmein"

## (Hazreti Hadixheja)

### "radijell-llahu te ala, anha (2)"

Hazreti Hatixheja është e shoq e hazreti pejgamberit e cila sulltane, para islamijetit quhej: Tahire po si u martua me Resulull-llahun u qojt: Hatixhe e madhe. Kjo mëmë ka qënë fort e mënçëm, e sojit, e pasur. Një natë kish parë ënder se djelli u këput prej qellit edhe hyri në shtëpin e saj masandaj drita e djellit flaku dë Meqqe. Kur pyeti dijetarët i thanë: (myzhde! se tinë do të bëhesh e shoq e ati të math pejgamberit që do të flakë dritë në Meqqe.) Hazreti Hatixheja që ish hanedan edhe malldare tepër, prej disa mbretërivet ish kërkuar po Zotri e saj s' i kish pranuar. Kur pa ëndrën e sipër shënuar, dashuri e mallit j' u xvorth e me një dëshirë

(1) Se prej 40 vjet e këtej toka Afrikë po thuaj u bënë mysliman tërë të cilën po e vërtetojnë edhe të huajtë në për gazetat.

(2) Kuptimi: Zoti qoftë razi nga kjo mëmë.

të madhe priste atë kohën e uruar q' e kish përgëzuar dijëtari me ëndër. Kur u çfaqnë sheshit mrekullitë e hazreti Muham-medit, me anën e mesësvet këmbyenë fjalë edhe të falë masandaj bënë hitbe edhe niqah. Hazreti Hadixheja më të dy jetë quhet kryetare e mbesimtarevet. Kjo mëmë ka lindur dy djem e katër bija të cilat quhen: Kasëm, Abdull-llah, Zejneb, Rukijje, ym-mi qelthum, Fatime. I miri pejgamber më të vogël e më të dashur kish hazreti Fatimenë prej së cilës ka erdhur Imami Hasan dhe Imami Hysejni, far e fis i Resulull-llahut gjer sot e gjer më kijamet po rjeth nga hazreti Fatimeja.

## (Hazreti Aisheja)

### "radijell-llahu teala, anha"

Hazreti Aisheja është bij e hazreti Eba-beqirit e cila mëmë, mbas vdekjes të Hadixhe-sulltanit u bë e shoq e hazreti pejgamberit nga që kish dëgjim edhe drejtësi të madhe u qo't: Siddika. Kjo Zo'neshë-me evlat s'u bë dot mëmë po me dityri të madhe u bë një dijëtare sa habitshin gjith sahabeja. Mbas vdekjes të hazreti pejgamberit nga Zotri e saj sahabeja ka ë bler shumë fetva edhe dijë e cila nga goj e Resulull-llahut ka treguar 2110 hadithi sherife. një nga sahab të e lartë kish thënë: më të ditur se Aisheja ne botë s' kemi parë Kjo mëmë kish edhe xhymertllëk të math, një ditë vobegvet kur j' u përndavi 100,000 dërhem të holla (3000 flori) përndavi edhe sendet e shtëpisë e cila mbajti vetëm një këmishë për veç këmishës së trupit, pas pak orë kur i vjen një vobeg tjatër i fali këmishën e veçantë edhe mbeti vetëm me këmishën e trupit, mi nderimin dhe mi s' pastrimin e saj kanë zbritur disa ajeti qerime e

cila në muajin e bekuar Ramazan ndëroj jetë dë "Medinei mynevvere" (1)

## (hazreti Fatimeja)

**"radijell-llahu teala, anha"**

I miri pejgamber kur u bë (41) vjet, i ka lindur hazreti Fatimeja e cila ballë hënë hazreti pejgamberit i ngjiste tepër, stolinë edhe dashurinë e kësaj bote s'ja kish kënda fare po vetëm Zotit me të mathvet i falej dit e natë, në jetën e saj as një namaz, kaza nuk i ka mbetur, nga që e la mëma të vogël, i miri pejgamber zu e dashuronte më tepër, në hënën Dhil-hixhe u bë niqah me imami Alinë, hazreti Fatimeja nuku kërkoj pajë, po në vënt të pajës luti shefa-atin e Resulull-llahut të veçojë në atë jetë për gratë mbesimtare, kjo mëmë e uruar të shoqin të vjerhën e nderonte, vobegët, sherbëtorët i përgëzonte tepër, bijt e saj i shëkonte mirë shtëpin e saj e regullonte krejt. Zotri e saj kish një kanaet edhe për vobegët kaqe një merhamet sa shumë herë nafakan e saj ja u përndante të varfërvet edhe vetë mbetej e urët. Ish nje zemër bardhë që me gojë këndonte Kur-an, me sy lëshonte lot, me duar regullonte nevojat e shtëpisë, mbas vdekjes e të mirit pejgamber ka rojtur gjashtë muaj, në muajin e bekuar Ramazan në moshën 25 vjet ka ndëruar jetë e cila ësht varosur pran Resulull-llahut.

---

(1) i miri pejgamber natën kur bënte ibadet sa gjer i ernjëshin mybareq këmbët, Ajsheja i thoshte: ja Resulull-llah! Zoti i lavdëruar gjynahet e tua i ka dhuruar ce i jep kaqe mundim trupit? athere përgjegjej i miri jonë: për gjith ate te mira edhe nderime që na fali Zoti si të mos t'i bënj shyqyr Zotit! (se shyqri provohet me fjal e me punë).

# (Imami aezemi Ebu-Hanifeja)

## "rahmetull-llahi teala alejhi'

Nga të katër imamët e mbëdhenj që quhen Hanefi, Shafi-i, Maliqi, Hambeli, i pari dhe m'i mbaruari është Imami eazemi Ebu-hanifeja i cili ka lindur mbas 80 vjet të datës hixhretit atë dijë q'i përhapi myslimanësisë nuk munt ta thenj dot të cilën i miri peigamber e ka lëvduar me këtë hadithi sherif: (në ym-met tem do të vijë një dijëtar që emrin e ka Nuuman, titullin Hanife (i cili është drita e ym-metit tem. (1) imami eazemi mësimet e para i ka marë prej imami Xhafer Sadikut masandaj mësoj prej Imami Ham-madit pastaj u jepte mësim me mijra talebevet i cili ka arirë katër sahabe. Zotri e ti dë muajt zbriste 60 hatmë, me abdestin e Jatsisë 40 vjet ka falur faljen e mëngjezit, se tërë natën bënte ibadet, ditën agjërim edhe jepte mësim, dijë, fetva, me mijra myslimanvet. Bashkë me këtë punonte edhe për dynja që të përfitojë jetën e pasosur me hajrat e me sadaka i cili me anën e tregëtisë ishte bërë një zengjin i math sa yshqente me mijra nxënës, vobeg, udhëtarë pastaj për din e për vatan bënte hajrat edhe ndihma të mbëdha të cilat nuk munt të nëmërohen se myslimanët e parë, gjënë e përfitonin dhe e harxhonin për din, për vatan, për mil-let e jo për qefin e vetë, shumë Krishterë edhe Çifutë kur shihnin këto drejtësit e ti bëheshin mysliman, nga mëndja e nga dija ishte kaq i fellë sa habitshin e po habiten gjith bota e qytetëruar, si ç' do njeriu me fjal a me punë i bënte derman, halifeja e asaj kohe i bëri teklif kadillëk (2) po Zotri e ti-nga fri-

---

(1 Këtë fjalën e prasme e përsëriti tri herë. Imam eazem d. m. imam i math po asëll emri: Nuuman bi: i Sabitit.

(2) d. m. (sheh islam) mi gjith myslimanët

ka se mos hyjë dë hakën e popullit, s' e pranoj, 55 here vajti dë Qabet edhe Resulull-llahun kur e bënte zijaret po-për nderim nuk hynte dë Medine po ngrehte çadëren gjysmë ore jashtë Medinesë, atje merej me ibadet e me lutje shefa-at gjer i vinte lejë nga Resulull-llahu, në vizitën e 55-të një tregëtar paskë hambur 7,000 florinj i cili me kokë të prishur kur qante hallë de tyrbe e Resulull-llahut, i erdhi një zë: tregëtar! (çap në filan vënt ku ndodhet një i dashuri im të cilën e quajnë Numan edhe prej meje jepi selam e i thuaj: hajde se të kërkon Resulull-llahu, at-here dëshira tënde mbarohet) tregëtari posa dëgjon këtë zë vete de imami eazemi e i thotë: ja Numan! Resulull-llahu të çon selam e po të kërkon). Imami eazemi kur mer këtë myzhde, tregtarit i fali 1000 florinj, po nga gëzimi e pyeti prapë: o i lumtur i bekuar! më të lumtë ajo gojë, as më thua edhe një herë si urdhrove? tregtari kur se ja përsërit prapë selam edhe qelamin e Resulull-llahut, Imami eazemi i fali gjene 1000 florinj, po Imami eazemi që ish ndezur me ashkun e Resulull-llahut e pyeti prapë sa kjo pyetkë edhe përgjegje vazhdoj 7 herë në të cilat imami i fali 7000 florinj, dëshira e tregëtarit që ish për ato 7000 florinj u mbarua edhe prej imamit u nda, po imami eazemi tregëtarit i ka thënë: kjo myzhdeja jotë është asoj një myzhde e madhe sa si kur të ma përsërinje 100 herë, do të të falnja 100,000 të verdha, masandaj imami eazemi u nis të vejë de tyrbe e Resulull-llahut dyke qarë e dyke lëvduar me atë Kaside (vjershë arebisht) që niset:

ja sejjidessadati! xhiëtyqe kasiden.
erxhu ridaqe vahtemi bihimaqa!
Kryesija shqip:
(o i madh i botës! për ty kam qëlluar
lus kënaqësinë prandaj kam mënguar

veç me ashkun tënde ndizet zemra ime
Ay **Zoti** vetë ma di flakën t' ime)
të cilën kaside e kemi përkthyer shqip në atë librë që mbështjell të pesë kasidetë e Imamllarvet

Dë falien e xhenazesë të hazreti Imamit thuhet se janë mbledhur 150,000 myslimanë i cili turbenë e bekuar e ka dë Bagdat "rahmetull-llahi te-ala alejhi ve nefeanell-llahu bishefa-atihim, ve fujuzatihim amin!

SHËNIM:

Në botën myslimane me famë kanë dalë me mijra dijetare edhe dijëtarë të mbëdhenj për të cilët në ç' do gjuhë kanë shkrojtur libra të veçanta me barrë po neve shyqyr t' i bëjmë edhe kësaj së pakës në paçim dëshirë munt të shohim dhe të tjera pra: në duamë të mprojmë e të përparojmë fenë, populli myslimanë këto pika t' i marë parasysh e t' i përkrahë mirë se dë vatan të Shqipërisë Feja mbas këndai munt të mbahet vetëm me anën e libravet besare. Rop i mjerë po të punojë, mëshirë ploti dot i ndihmojë.

Qoftë Salaty selami mi sulltan e gjithësisë
Dhe mi tërë pejgamberët, të mirit e njerëzisë

---

*"Hadha minfadli Rrabbi" (tem-met biavnihi teala "elibaji islam" nahmedull-llahe teala ala tevfikihi vefadlihil-adhim, ve nes-ely en jexh-alehu nefëan lilmyeminati vel myemimin, ve dhyhren lena fijevmiddin bihyrmetil-en bijái velmyrselin vel hamay lil-lahi rabbil-álemin"*

*elfekiru, elhakir vel myhtaxhy*
*ilá rahmeti Rrabbihil-kadir*
*ahkarul-ibadë: Hafëz Abdull-llah.*

# Çështje feje një artikull:

## (ve ma alejna il-lelbelagul mybin.)

## ajet: kemi detyrë të flasim fjalën e drejtë

Në për gazetat herë herë shohim ca njerës që dënë titullin mysliman-çështje feje-japin artikulla me të cilat kritikojnë fenë edhe dijetar t e fesë ma andaj duanë të thonë se feja lipcet të ndreqet si mbas qefit edhe zakonit të kohës. Për të dhënë këtyre përgjegje disa mbesimtarë më kis in ngarkuar, po neve me këta njerës s' kishim qëllim edhe kohë që të haneshim me gazetë për herë se fjala shton fjalën, për vatan e për qetësinë e vatanit nuk e shiqnin të arësyshmë po posa që nuku rinë urtë, përgjithësisht nj her e mirë dot u japim një përgjegje të cilën jo në gazetat që të këndohet një orë a një ditë, po do ta çpalj dë këtë librë që të rojë e të këshillojë për jetë.

Këta njerës që quajnë vehten të ditur, të mënçëm e të qytetëruar a nuk menjtojnë pak se ajo Fe që ka ngrehur i Zot i Fesë është udhëheqës e jo ndjekës si mbas qefit t' onë, kush i bëhet ndjekës edhe besnik fesë është fetar edhe mbesimtar në mos, ësht i ndarë, Fesë do një dëm nuk i bëhet, si kush dëmin ja bën kokës së vetë. Feja sa të jetë bota më këmbë është baki, dë Kur-anin e madhënushmë për këta njerës që pëlqejnë mëndjen e vetë vjen një ajet (në sure i Bekare) (. . . .) Z. e. m. kuptimi: (atyre që duanë të bëjnë punra jashtë fesë kur j' u thuhet: dë faqet të dheut mos bëni ligësi edhe p apësi, ata thonë: neve jemi ndreqës edhe mirëbërës. a i shëken atal ata janë ca mëndje prapë që prishin punë po-mjerisht-prapësin nuk e kuptojnë) kjo ajeti qerime që ka zbritur 1000 e kaqe vjet më parë është një muxhize se kësi njerës vet pëlqenjës që lëvdohen me fjalë e jo me punim, në ç' do kohë ka patur si kundër që ka edhe sot.

Urdhron i miri peigamber "alejhissalaty vesselam: (mbesimi nuku është me të ngarkuar emrin ose me të treguar vehten mysliman po është një dritë që ka vendosur dë zemër të cilën e

vërteton punimi) se mbesimi edhe punimi janë vëllezër të cilët shëmbëllehen si toka me punimin e tokës d. m. në tokën e mbesimit po të mbjellësh e po të punosh, do të mbijë, do të lulëzojë më së fundi do të japë edhe pemët e mbesimit, ata që s' marin dot shijë edhe pemë nga Feja, vjen nga mos punimi, se dija pa punim thonë është si druri pa pemë k' të fjalë do ta provonj edhe me një lajmë të re që pamë-ca kohë të shkua a-në për gazetat të cilat na tregonin ngjarjen e një miljoneri amerikan qysh u bë mysliman? për shkakun që pranoj besën myslimane kur u pyet ky amerikan paske thënë: (unë nië ditë kur merrja kadron e një mujezzini që jepte ezan dë Miraret, ajo shija shpirtnore e ezanit më hyri dë palcët të zemr's edhe shpirtin ma dogji, masandaj për një provë-me atë myezin arëb u zura mik edhe me të disa dit fala të pesa, kur at' herë sh ja edhe fuqija e fesë myslimane erësirat e zemrës m' i çpërlavi fare, me pemët e mbesimit u shijova mirë e vërteta m' u çfaq shenjt si djelli at' here e vendosa të bëhem mysliman edhe që kur hyra de kjo fe, shpëtova nga gjithë zgjedhat e nefsit veçan nga ajo lakmi e shkretë që s' më linte rehat në jetë, se si do që isha miljonar, me të holla nuku ngopsha edhe sendër nuku kisha fare po tani me një shpirt qetësi jam i lirët e i çkëlqyerë.)

Me këtë lajmë neve duamë të vërtetojmë hadithi sherifin e dhe fjalët e sipër shënuar. Mjerisht sot ca që thonë jemi myslimanë-po nga punimet e fesë janë zero-oyke treguar vehten si dijetar ose i qytetëruar hidhen e kritikojnë fenë edhe dijetarët e Fesë po sëmundjen e vet nuk e shohën.

(Lakuriq i natës s' e do djellin kurrë
I ka fajet vetë q' i ka syt' sëmurë
Nuk i shijon ujët i kulluar sërmë
I ka fajet vetë, e ka gojën çermë)

Po çudi e madhe se ca zhonë që s' kanë vënë kryenë më sexhde kurrë, kaqe trimërohen sa thonë të bëhet një ndryshim fe të falen mi karekllë se vet pëlqimi nuk i le të vënë kryenë për dhe, e të japin robëri para fuqi madhit.

(Si s' mejtohesh o i gjorë! se ti s' ishe krejt[ë] në jetë
Me gjith mëndje të krijovi ajo fuqi e vërtetë
Nga Feja që fali **Zoti** si tregohesh më i ditur
A e shëkon prapësirën edhe gradon sa ke zbritur
Ti o rop! nga mëndje fal i si thua jam më mëndje plotë
A e mer këtë kalemi? a ka turp si kjo botë?)

Ata që shesin kësi mëndje thonë: Sheriati kur jep lejë të falet falsi mi kalë, e ce të mos falemi edhe mi karekllë?

Po shkagjet e lejës nuk i kujtojnë fare. këtë liri sheriati e jep po dë një luftë ose dë një udhëtim e sipër që s' ësht e mundur falja për dhe si nga shiu, nga dëbora, nga baltrat e jo kudo, liri ka edhe për të s'murit që s' ngrihen dot më këmbë të cilët falen ndenjur me shënim, se feja ropin e ngarkon si mbas fuqisë së vet, dë një vënt që s' kemi ujë, kemi liri të falemi edhe pa abdest d. m. me tejemym, ata që thonë sot, të falemi mi karekllë, nesër munt të thonë hajde të falemi edhe pa abdest e pa gusël, se kemi tejemym, po vallë a do të bejnë edhe Tejemymin?

Tani do ta përsëritem edhe një herë atë fjalë që thamë më parë se Feia është udhëheqës jo ndjekës si mbas qefit t' one. Mbesimtarët tjatër udhëheqës nuku njohin se i miri pejgamber alejhissalaty vesselam na ordhron: (ati ropi që detyron kondra besës së **Zotit** ndjekës mos i bëh) me këtë hadithi sherif kuptohet se ata krerë ose siutete të tjerë mysliman që detyrojnë kondra rugës së vërtetë, çështje Feje,-për neve udhëheqës nuku janë. Myslimanët e faqes së dheut udhëheqës njohin vetëm një hazreti Kur-an edhe ata që punojnë si mbas hazreti Kur-anit se pasqyra e njeriut ësht punimi e jo fjala edhe lëvdimi.

Me shkakun e ca hoxhallarvet të pa ditur kur bije fjala kritik.hen tërë dijetarët e Fesë edhe thuhet: (këta janë pengë) po ata dijetarët e parë që ishin mi të mbaruarë nga gjithë kombet, ce nuk pengonin istorija sheshit po na thotë se feja myslimane kur lindi nga tok e uruar Arebistan, në pak kohë nga gjith kombet përparoj, mbretëritë më të mbëdha i zaptoj sa gjer më deti Atlas edhe Hindi kaloj, veçan në kohën të Emevi e të Aba-

sivet-nga dija e nga mjeshtërija-kaqe përparuanë sa u bënë profesorët e kombevet të huaj, europianët a nuk vinin mernin dijë dë shkollat myslimane të Ispanisë? me pallatet e mbëdha si "Elhamra" dhe me xhamirat e mbëdha selatin që kanë ngrehur myslimanët në Ispani edhe gjetkë a nuk po habiten edhe të sotmit? librat me volym e miljarë që kanë lënë ata dijetarë a nuk janë përkthyer në gjuhërat europjane? po ata profesorë a nuk qenë Myderris edhe hoxhallarë? dijetarët mysliman në ç' do kohë njerëzimin, qytetërimin veçan drejtësinë e kanë përkrahur sheshit xhen-net meqan s'ilan Selim merhumi, (1) mi një çështje tradhëtimi kur j' u zemrua grekërvet të Stambollit ju tha: (ja se të bëhi mysliman i se të çpori nga ky vatan). At' here a nuk i dua allë përpara ata dijetarët hoxhallarë që e ndaluanë mbretin-me fetva-nga kjo punë? elementët disa herë me anën e dijetarëvet janë mprojtur edhe gjer më sot kanë rojtur me nder, se Feja myslimane nderjen e ç' do ropi veçan bakën e të huajvet e mpron dhe e ka mprojtur më mirë nga ërë kombet. Çifutët për të shpëtuar nga vrasjet e Kristjanizmës, më shumë futnin kokën rë tokën e myslimanvet dijetarët e parë, fjalën e drejtë se ndruanin kurrë një ditë merhum Zimbil li Ali efendi dijetari Sulltan Selimit me të keq i tha: (Shëko se po 'o,te nga Sheriati e nga drejtësija,-me fetva-të krej nga mbretërija) po paçin ndjesë edhe ata të uruar mbretër që me fjalën e drejtë të ulemavet nuk zemrohshin kurrë po puthnin dorë edhe këmbë. Tani ce nuk shikojmë ata dijetarët e parë qysh kanë punuar? po shohim ca të pa ditur që dalin më qindit një edhe me këtë shkak i bëjnë fajtor të tërë,? kështu taklitçinj ndodhen në çdo komp e në ç' do degë, veçan ndaj neve jo vetëm në degën e dijetarvet që quhen ehli sheriat po mos ka edhe në trupin dervishan që quhen ehli tarikat, prej këtyre

(1) I cili ka qënë një mbret me fame që drodhi europën e tërë, de nëntë vjet zaptoj shumë vise sa u njoh halife e gjith myslimanvet në botë, një ditë kur shëtente haritën e botës paske thënë: unë pandeuja se bota është do një tok e madhe po më duket se qënka sa për një mbreteri.

si kur të shohim ca njerës që flasin a punojnë na udhë a mund tja u hedhim fajin tërë ti pit? fjala që flitet dëne drizat-që zjoja shpirtret hyjnë de-njeri tjatrit nga këta të pa ditur ka dalë, këto a janë fjalë q' i pranon mëndja ose njerësimi? (1) athere ce nuk i qertojmë pakës edhe këtu? me fjal'n e ca të paditurvet një trup i tërë me faj nuku zihet kurrë. Ca istorira a masallë të tepërta që ja u ngjitin ho ballarv t, nuku kanë dalë nga mëndja e dijetarvet të mbaruar po ka'ë mbetur nga librat israilinj, se që moti ca dijetarë çifut kur bebs'in myslimar, në ca libra fetare i futnin edhe këto istorirat e vjetra israilinj, tani tërë trupi dijetar ce të zihet fajtor? botës a mund t'u mbajmë dorën ose gojën? edhe sot dë Misir ka misjonerë të huaj që hyjnë në kijafetin e dijetarvet tonë të cil t me këtë vegël dë mes të myslimanvet mundohen të futin kësi masallë të vjetra me qëllim që të na flohin fenë t'onë dë syt e botës. E po edhe tani do ta zemë me faj trupin mysliman ose fenë myslimare ose dijetarët myslimanë? cili shet mall të mirë cili shet gjënë kallp t dë marë dhë një vështro sytë i hap mirë, dëstur edhe udhë rrënjës kemi hazreti Kur-anë i cili sa të jetë b ta më këmbë nuku lot, tjatër ç' kërkojmë? misjonerët, na'esiqa, të huajtë le të përpiqen sa të duan e anë nur edhe dëstur nuk e lëzin dot kurrë, që ku lint e gjer ku perëndon ezani Muham-medija po valon sheshit nga pesë herë në ditë."

Në tokën e madhe Afrikë për qëllimin e tyre misjonerët edhe të huajtë sa do që u përpoqnë po nuk patnë dot se ç' të bëjnë gjer drita e myslimanësijës bëri ballë edhe Aferikën e mbështolli tërë! se Feja myslimane do të jetë ba'i edhe ebedi. tjatër ç' do të themi? mjeshtëririat edhe qytetërimet e kohës lipcet t'i kapim edhe popullin ta përparojmë po kjo: nuk përfitohet me fjalë ose me të ndryshuar zakonet e Fesë e të kombësisë se mëndja e-bëe de kokë drita është në zemër sa të ndryshojmë ng yrat edhe fytyrat, më mirë të gjejmë thelbin me punë, dë këtë hakë që Kur-an'n e naltë kemi disa ajet: (… … )

(1) Këto fjalë nuk i pranon as një nga [illegible]

esteidhy b'l-lah. z. e. m. (në këtë botë njeriu i gjallë ç'të punojë atë dot përfitojë e dot korrë) dë një ajet tjatër detyrohemi reptësisht që me sa kemi fuqi kundrejt të huajvet edhe kundërshtarvet t' pregatitim ato fuqitë më të forta që e lyp koha që të trembim armikët e të mprojmë dinë edhe vatanë me nder. Prej një mij' e kaqe vjet e la, tërë myslimanët që kanë erdhur dë faqet të dheut hazreti Kur-anë e kanë njohur (e kanë mbesuar) edhe po e njohin pa dyshim që është fjal e **Zotit** me të math vetë. Kondra këti mbesimi do një komp mysliman gjer më sot nuku ka ardhur istorinë e kemi sheshit pra: ata që ngarkojnë emrin myslim edhe thonë jemi mysliman,-si vëlla-po j' u këshillojmë t' heqin dorë nga këto fjalët e pështira që sjellin ftohtësi në vatan e në mes të mbesimtarvet, jo, në janë kondra këti mbesimi që kallzon i madhënushmi Kur-an, athere ju themi: për jasl.toi sheshit nga ajo fortesë që kini hyrë me emrin mysliman që të dimë si të flasim? se mysliman, quhet ay që mbeson hazreti Kur-an, të tjerit nga ay turp nuku janë ata që s' janë nga ky trup, po të ç' kallojnë shumë kanë përgjegje me këtë ajet: (leqym dinvqym vë lije, din); kuptimi: Z. e. m. (thuaju: o juve kundërshtarë që s' pëlqeni fenë e vërtetë! mos i zgjatni fjalët shumë po juve mbani besën t'aj, neve kemi besën t' onë.)

D. m. th. si kush le të shëkojë punën e ti, se në Fe ç' do rop është i liret.

---

## Vëllazërvet mbesimtarë!

E folura fjalën e drejtë si për ç' do mbesimtar mysliman po veçan për dijetarët e Fesë është farz. Kjo detyr e shenjtë ka qënë edhe -ila mashaell-llah-do të jetë, pra shyqyr edhe lavdërim i japim ati mëshirë madhit që na ndihmoj të flasim fjalën e drejtë të cilën e provuame me dëshira mendore edhe istorike. Dijetarët e parë që dinin ku zihen shtegjet, me fjalë e me libra kanë luftuar me gjithë botën të cilvet nuk ju ka bërë dot ballë ajeri kurrë se Feja mysiimane që përmbahet me shtyllën e pa tundur baz-

reti Kur-an, ç' do gjë e ka dreq edhe shesh e drejta rënjat e shëndosha i ka ngulur dë dhet, degët e nalta i ka më qell pra: ç' do mbesimta ç' është feje kur të hahet me një kundërshtar më parë të mësojë ku zihen shtegjet d. m. kundërshtari në qoftë se s' pranon ajet edhe Hadith at' here -me urtësi- fenë do të ja provojë me dëshmira mendore edhe istorike (delili akli, ve nakli) se feja myslimane detyron vetëm ato gjëra që vërteton mëndja edhe historija. Jashtë mëndjes nuku del as një halë, pyesim? nga ato sende që ka detyruar ose ka ndaluar Feja myslimane cilat gjëra mëndja nuk i pranon?

Më e para qellime i shehadeti njëjton çpiksin e gjithësisë, vërteton të mirit e njerëzisë falja, hoxhësija, provojnë robërinë, bashkojnë vëllazërînë.

Agjerimi përkujton varfërinë veçan shtyp ato orekset kafshëror që tërbojnë njerinë Zeqati (dhe e dhjeta) shëndosh vatanë, përgëzon fukaranë.

Nga ndalimet të sjellim nj' a dy shëmbëll: Feja myslimane prej 1000 e kaqe vjet, pirjen edhe kumarë e ka ndaluar krejt, këtë ndalim si kur ta gjykojmë me mënt a me istori, a ka parë njeri prokopi? sot më ca vise të qytetëruara këto gjëra ce zunë po i ndalojnë? se e provuanë që janë të liga po Feja mysliman këto mëndje i ka njoftuar që dë kryet të besës. Tani të tjerit le të marin pjesë. Mirvetijat që detyron reptësisht Feja myslimane po i kemi treguar në këto librat besare si kush le t' i ndjekë e le të mbushë kokë. Fjal e drejtë është e drejtë po për shpirt sëmurit është e hidhur-për të shëndoshit zemër qëruar është e ëmbël dhe fort e shijëshmë (felil-lahil hamdy).

---

Ja men telexh-xhemel-myteqeb-birine bilixhami qibrijaihi! sel-lim sel-lim ja Hafidh! vehdine ve xhemial-myslimine ala ithril-mehdijjine ja hadi ja hadi!

BKSH

BKSH

Librat t' ona fetare kërkohen në dyqan të hafëz Eminit në Korçë me hedijen e posht shinuar:

| | | |
|---|---|---|
| 1 Mevludi Sherifi me 64 faqe: | korona sërmë | 3 |
| 2 Kasideja | „ | 2 |
| 3 Hytbeja me zjitë tefsirin e Jasini sherifit | „ | 2,50 |
| 4 Hytbe e dytë (Muhammedija) me 100 faqe vjershë: | „ | 3 |
| 5 Bilbil i Prillit: | „ | 2 |

(Kto librë me kartë dhe me dy palë kapak fort të mirë është 2,50

Kërkonjsvet të jashtmë ja u dërgojmë me postë. Spenzimet-për kitësirë i heqim vetë.

Zotrinjvet këndonjës lutemi: këto libra besare që kanë brenda ajetja besmele, ta mos i lëshojnë për dhe, po sa të mundin t'i mbajnë paq edhe me nderim.

## TABLË E SHUMËZIMIT

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
| 2 | 4 | 6 | 8 | 10 | 12 | 14 | 16 | 18 | 20 |
| 3 | 6 | 9 | 12 | 15 | 18 | 21 | 24 | 27 | 30 |
| 4 | 8 | 12 | 16 | 20 | 24 | 28 | 32 | 36 | 40 |
| 5 | 10 | 15 | 20 | 25 | 30 | 35 | 40 | 45 | 50 |
| 6 | 12 | 18 | 24 | 30 | 36 | 42 | 48 | 54 | 60 |
| 7 | 14 | 21 | 28 | 35 | 42 | 49 | 56 | 63 | 70 |
| 8 | 16 | 24 | 32 | 40 | 48 | 56 | 64 | 72 | 80 |
| 9 | 18 | 27 | 36 | 45 | 54 | 63 | 72 | 81 | 90 |
| 10 | 20 | 30 | 40 | 50 | 60 | 70 | 80 | 90 | 100 |